

**SBASHK****Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures**

Arsimimi

KULTURA E NJERIUT*Ë-buletin***Shkurt, 2021**

Kontrata e re Kolektive së shpejti shpërndahej te anëtarësia **Respekt për ata që kontribuan në përgatitjen e saj**



Nga çështjet kyçe e tepër të rëndësishme të angazhimit sindikal është edhe përgatitja dhe krijimi i kushteve për nënshkrimin e Kontratës Kolektive. Sindikatat kudo në Ballkan, Evropë e tërë botën një luftë të vërtetë sindikale e zhvillojnë dhe kalojnë nëpër sfida e strese në përpjekje për të shënuar arritje e të drejta sa më të mëdha për anëtarësinë. Kjo arrihet, jo lehtë, përmes Kontratës Kolektive të sektorit, e cila përcakton, por edhe garanton të drejta, benefitet, por edhe obligimet e palëve. SBASHK-u edhe në këtë aspekt ka vend dhe arsye të krenohet ngase me punë e përkushtim ka ... (faqe 4)

Veprimtarët sindikal Rexha, Murati e Selimi

U pensionuan, po në SBASHK do të jenë tërë jetën

SBASHK përgatit me kujdes e respekt çdo vit mirënjohje për pishtarët e dijes për të lartësuar kujtimin ... (faqe 10)

Bisedë me koordinatorin për organizim të brendshëm Ymer Ymeri

Filluam edhe këtë vit me arritje e suksese, kështu do të vazhdojmë



Janë të shpeshta ... (faqe 3)

Takimi me kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të Universiteteve

Arritjet, zgjedhjet në SBASHK dhe aktivitetet për ditën e mësuesit



Krahas komunikimit të vazhdueshëm ... (faqe 9)

Takimi i Komitetit të Përhershëm për Barazinë Gjinore të ETUCE-së

Sigurimi i barazisë dhe arsimit gjithëpërfshirës në raste emergjente



Me 16-17 shkurt 2021 u mbajt ... (faqe 8)



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
The Union of Education, Science and Culture

Editorial

Kujtesë për pishtarët e dijes



Marsi nëpër dekada e shekuj është skalitur me data e ngjarje të mëdha për kombin tonë. Një nga këto ngjarje është edhe data e madhe e 7 Marsit, që tani e sa dekada me krenari e respekt kujtohet për të lartësuar kujtimin për pishtarët e dijes, që ishin luftëtarë të denjë të dritës kundër errësirës. Këta njerëz të dijes u dëshmuan dhe iu përgjigjën gjithmonë zërit të atdheut. Ata e ruajtën në zemër Abetaren dhe me shkronjat e arta kanë lënë gjurmë në faqet e ndritura të historisë duke skalitur ngjarje e emra trimash të ngjarjeve e përpjekjeve për liri. Shkolla shqipe me mësuesin ishin dhe mbesin vlerë e lartë e kombit. Ata gjithmonë u kthyen në fortesë qëndrese dhe i përballuan sulmeve e furtunave të pushtuesit. Shkolla u bë çerdhe e lirisë dhe mësuesi ishte dhe mbeti në krye të misionit të

shenjtë të edukimit e arsimit të brezave. Kush do të ishim ne nëpër shekuj e dekada pa shkollën dhe zërin kumbues të mësuesit? Ku do të thuheshin e ruheshin këngët për trimat? U ruajtën, u kultivuan dhe i stolisën me bukurinë e shkronjave shqipe në vatrat e dijes. Prandaj, krahas lirisë, gjëja më e shenjtë e një kombi është shkolla e njeriu më i respektuar mësuesi.

SBASHK-u me vite e dekada ka shënuar në mënyrë madhështore këtë datë të madhe. Do ta shënojë edhe këtë vit në mënyrë më modeste, krahasuar me vitet tjera kur bënte bashkë qindra pishtarë të dijes në kryeqytet dhe u shprehte respekt meritë me rastin e pensionimit të tyre duke shprehur respektin e lartë e meritë për punën e madhe të tyre në edukimin e arsimit të brezave. Pandemia solli shumë pengesa e probleme. Ajo e ndryshoi tërë botën, por SBASHK edhe në këto rrethana do shënojë datën e madhe të shkollës e mësuesit brenda mundësive e rrethanave të reja. SBASHK-u për jetë e mot do të ruajë e do të shprehë respektin meritë për luftëtarët e dijes kundër errësirës.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazeten e juaj elektronike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)

përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel. +383(0)38/ 226 940



Intervista

Bisedë me koordinatorin për organizim të brendshëm Ymer Ymeri

Filluam edhe këtë vit me arritje e suksese, kështu do të vazhdojmë



Janë të shpeshta bisedat që zhvillojmë për gazetën tonë me koordinatorin për organizim të brendshëm në SBASHK dhe kjo ndodh me qëllim që për lexuesit të sjellim informacione nga dora e parë për sfidat, aktivitetet dhe arritjet aktuale. Të njihemi nga afër se si u nis ky vit nga SBASHK dhe çfarë tutje?

Në pyetjen tonë se si nisi ky vit për SBASHK-un, Ymeri tregon se janari solli sfida dhe angazhime konkrete. Duke u angazhuar në realizimin e dy kërkesave të anëtarësisë janë zhvilluar shumë takime me institucionet. U takuam edhe me Kryeministrin Hoti. Ishim para një momenti sfidues kur çështja erdhi ose me dialog e marrëveshje ose veprime sindikale. Fatmirësisht ndodhën takime dhe erdhi edhe te marrëveshja për shtesën në paga për arsye të shtimit të volumit të punës dhe të rrezikut të shtuar nga Covid, tregon Ymeri.

Nga aktivitetet që u është dhënë kujdes merititor, siç thotë Ymeri, është edhe angazhimi që në këtë vit zgjedhor në SBASHK ky aktivitet të ketë rrjedhë të mbarë dhe me votën e lirë e në një konkurrencë të fortë të dalin organet e reja që nga shoqatat sindikale, në njësi akademike e deri te organet më të larta të SBASHK-ut. “Jemi në komunikim të vazhdueshëm me veprimtarët sindikal dhe të gjithë jemi të përkushtuar e të vendosur që procesi zgjedhor të ketë rrjedhë të mbarë, për këtë edhe kemi përvojë të shkëlqyer.”

Ymeri tregon se me kohë janë formuar edhe grupet punuese dhe komisioni qendror zgjedhor. Zgjedhjet që nga shoqatat do të jenë të monitoruara nga komisionet gjegjëse dhe do të respektohet në tërësi Statuti që qartëson rrjedhën e zgjedhjeve. Jam i sigurt se do të zgjidhen kolegët që për momentin janë më të gatshmit për t’u përballur me sidat, që nuk do të jenë të pakta.

Koordinatori veçon edhe angazhimet për shënimin sa më madhështor të ditës së madhe të mësuesit dhe shkollës shqipe. Këtë vit ky aktivitet do të zhvillohet ndryshe, krahasuar me vitet tjera dhe jo pse deshëm ne, por kjo u diktua nga situata aktuale me Covid.

Ymeri në këtë bisedë tregon edhe për përgatitjet që ai bashkë me stafin janë duke bërë për të rinisur me organizimin e trajnimeve të licencuara me shpresën se numri i tyre do të shtohet sepse së shpejti pritet vendimi i Këshillit Shtetëror për Licencimin e Mësimdhënësve. Objektivin që të trajnohen për çdo vit 20% e anëtarësisë do ta realizojmë siç bëmë edhe vitin e kaluar, shprehet Ymeri, duke shprehur respekt për gjithë stafin qendror që vazhdon me angazhimet dhe përkushtimin.

Gjatë muajit

Kontrata e re Kolektive së shpejti shpërndahet te anëtarësia

Respekt për ata që kontribuan në përgatitjen e saj



Nga çështjet kyçe e tepër të rëndësishme të angazhimit sindikal është edhe përgatitja dhe krijimi i kushteve për nënshkrimin e Kontratës Kolektive. Sindikatat kudo në Ballkan, Evropë e tërë botën një luftë të vërtetë sindikale e zhvillojnë dhe kalojnë nëpër sfida e strese në përpjekje për të shënuar arritje e të drejta sa më të mëdha për anëtarësinë. Kjo arrihet, jo lehtë, përmes Kontratës Kolektive të sektorit, e cila përcakton, por edhe garanton të drejta, benefitet , por

edhe obligimet e palëve. SBASHK-u edhe në këtë aspekt ka vend dhe arsye të krenohet ngase me punë e përkushtim ka arritur vazhdimisht të përgatit me kohë versionin e Kontratës duke krijuar kështu parakushtet për nisjen e dialogut dhe negocimit me MASH-in. Kështu ishte edhe kësaj radhe. Përfaqësuesit e SBASHK-ut në këtë komision Vjollca Shala, Ymer Ymeri, Bardh Bardhi e Blendor Shatri punuan me përkushtim dhe përgatitën versionin bazë të Kontratës së re Kolektive për tërë arsimin e Kosovës. Ata me urtësi e argumente u prezantuan në komisionin e përbashkët me përfaqësues të MASH-it dhe pas takimeve të shumta që shoqëroheshin edhe me tensione e debate të nxehta , u arrit marrëveshje për tekstin final.

Me të drejt u prit se kjo punë e përkushtuar e komisionit të përbashkët do të rezultojë me nënshkrimin e Kontratës, por në këtë rrugëtim u paraqiten edhe probleme të natyrës teknike duke krijuar një atmosferë momentale sikur kishte hezitime në MASH për nënshkrimin e saj. SBASHK-u kësaj nuk hezitoi t'i përgjigjej me paralajmërimin për veprime sindikale, por duke i dhënë për ca kohë përparësi dialogut dhe takimeve me institucionet.

Ky mesazh u kuptua drejt nga institucionet edhe në dy takime me Kryeministrin Hoti e Ministrin Likaj u arrit marrëveshje përfundimtare dhe Kontrata u nënshkrua. Ajo është tani në procesin e botimit dhe së shpejti do të shkojë te anëtarësia dhe të institucionet arsimore.

Më poshtë po iu paraqesim disa nga nenet e Kontratës Kolektive:



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit dhe Shkencës / Ministarstvo Obrazovanja i Nauke/ Ministry of Education,
and Science

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË MINISTARSTVO OBRAZOVANJA I NAUKE I TEHNOLOGJIE MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOGY SEKTORI I ARKIVË-SEKTOR ARCHIVE-ARCHIVE SECTOR	
Njësia Org. Org. Jedinica Org. Unit	01/B
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	105
Nr. Prot. Broj Prot. Prot. No.	105
Data Datum Date	22.01.2021



Sindikata e Bashkuar e Arsimit dhe
Shkencës

Ministri i Arsimit dhe Shkencës (MASH), në mbështetje të nenit 145, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 4, 21 dhe 22 të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, nr. 82, dt. 21 tetor 2010), dhe shtojcën 6 të Rregullores nr. 02/1011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive (dt. 22.03. 2011), dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK) nënshkruan:

KONTRATË KOLEKTIVE

E ARSIMIT NË KOSOVË

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Me këtë Kontratë Kollective, Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (në tekstin e mëposhtëm SBASHK) dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëposhtëm MASH), pajtohen, që në mbështetje të Legjislacionit, në arsimin parauniversitar dhe universitar, të përcaktohen të drejtat e posaçme dhe obligimet e të punësuarve në institucionet publike dhe private, në arsimin parashkollor, fillor, të mesëm të ulët, të mesëm të lartë, shkollat speciale dhe arsimin universitar dhe të drejtat e obligimet e punëdhënësit, si dhe të drejtat dhe obligimet e palëve nënshkruese. Në këtë Kontratë mund të mbështeten dhe të përfitojnë edhe të punësuarit në kulturë, kur hartojnë kontratat me ministrinë përkatëse për ato dispozita që përbëjnë standarde të përgjithshme në marrëdhëniet ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit, të përcaktuara në Konventat Ndërkombëtare të Punës dhe në Ligjin e Punës të Republikës së Kosovës. Për kulturë, anekskontratrat lidhen në mes të ministrisë përkatëse, nga njëra anë dhe SBASHK-ut. Gjithashtu për organizatat sindikale komunale dhe DKA-në, organizatat sindikale



universitare dhe KD-të e universiteteve, qendrat burimore në kuadër të MASH-it, qendrat e kompetencës, në kuadër të AAPARR dhe shoqatat sindikale të shtëpive të studentëve. Me shtëpitë e studentëve mund të lidhen kontrata të nivelit të tretë.

Neni 2

1. Për të drejtat dhe obligimet që nuk janë përfshirë në këtë Kontratë, zbatohet legjislacioni në fuqi dhe Marrëveshja e përgjithshme Kolektive.

1.1. Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të arsimit parauniversitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë), qendrat burimore në kuadër të MASH-it dhe qendrat e kompetencës në kuadër të AAPARR), shtëpitë e studentëve dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, **të cilët janë anëtarë të SBAShK-ut.**

1.2. Dispozitat e kësaj Kontrate kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e arsimit, (komunat - DKA-të, KD-të - universitetet, institucionet e arsimit të lartë, shtëpitë e studentëve, qendrat burimore në kuadër të MASH-it, qendrat e kompetencës, në kuadër të AAPARR, MASH-in etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës.

Neni 7

Licencimi

1. Me licencim fitohet e drejta për punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shpërblyerje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi, dhe mbi bazën e licencës së fituar, bazuar në UA Nr. 5/2017 Sistemi i licencimit dhe i zhvillimit të mësimdhënësve në karrierë, u mundëson mësimdhënësve realizimin e stimulimit në të ardhurat personale, si vijon:

- 1.1 Mësimdhënës me Licencë të karrierës 10 % e pagës bazë.
- 1.2 Mësimdhënës me Licencë të avancuar 10% e pagës bazë.
- 1.3 Mësimdhënës me Licencë mentor 15% e pagës bazë.
- 1.4 Mësimdhënës me Licencë meritator 15% e pagës bazë.

Neni 11

Norma e punës

1. Norma e punës së të punësuarëve në sistemin e arsimit është në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.
2. Ngarkesa mësimore javore e mësimdhënësve në nivelin parauniversitar është 20 orë mësimi në javë.
3. Për punëtorët e Praktikës Profesionale në Arsimin Profesional norma është 24 orë në javë.
4. Mësimdhënësit që punojnë me klasa të kombinuara duhet të kompensohet për 20% mbi pagën e rregullt.
5. Norma e punës në universitete.
 - 5.1.** Ngarkesa mësimore për personelin akademik është e përcaktuar sipas rregullores në fuqi për të ardhurat personale, ndërsa për personelin administrativ sipas Ligjit për Shërbimin Civil.
 - 5.2.** Orët mësimore, që zhvillon mësimdhënësi mbi normën e caktuar sipas kontratës së rregullt të punës, do të paguhet si orë mbinormë deri në fondin e orëve të lejuara me Rregulloren për të ardhurat personale të universiteteve, gjithnjë mbi bazën e kontratës për orë mbi normë-honorar.
 - 5.3.** Universitetet - KD-të marrin përsipër që të vazhdojnë marrjen e masave të nevojshme për normalizimin e numrit të studentëve, duke synuar që brenda 2-3 viteve të ardhshme, grupet të kenë studentë

sipas kritereve të përcaktuara me rregullore të brendshme dhe sipas standardeve të arsimit të lartë, me qëllim rritjen e cilësisë.

5.4. Mësimdhënësit e cilësuar “invalidë pune” nuk mund të ngarkohen me orë mësimore mbinormë.

5.5. Nëse mësimdhënësi arrin moshën mandatare të pensionit, pas datës 1 tetor, përkatësisht ditën e fillimit të vitit akademik, ai/ajo mund të vazhdojë punën me pagë të plotë deri në përfundim të vitit akademik, përkatësisht deri më 30 shtator të vitit vijues, por kjo nuk nënkupton edhe të drejtën për ushtrim të funksionit menaxhues (shef dege, sekretar dege/departamenti, anëtar i këshillit të fakultetit, prodekan, dekan, senator, anëtar i KD-së, prorektor, rektor).


5.6. Për personelin administrativ dhe ndihmës, orari i punës është dyzetë (40) orë në javë.

- 6.** Ngarkesa e punës së mësimdhënësve të cilësuar si “invalidë pune” do të jetë në përputhje me propozimin e komisionit mjekësor.
- 7.** Për udhëheqës sindikal në nivel vendi (nënkryetari/ja, sekretarin e përgjithshëm dhe tre kryetarët e niveleve arsimore) norma do të jetë $\frac{1}{2}$ e normës së plotë, me pagesë të plotë me qëllim të ushtrimit të funksionit sindikal për mandatin 4 vjeçar.
- 8.** Për udhëheqësin sindikal në nivel komune (kryetari/ja) norma do të jetë $\frac{1}{2}$ e normës së plotë, me pagesë të plotë, me qëllim të ushtrimit të funksionit sindikal për mandatin 4 vjeçar.
- 9.** Për udhëheqësin sindikal në nivel shoqate (kryetari/ja) norma do të jetë 18 orë në javë, me qëllim të ushtrimit të funksionit sindikal për mandatin 4 vjeçar.
- 10.** Mësimdhënësit paguhën në bazë të normës së punës.
- 11.** Orët mësimore që zhvillon mësimdhënësi mbi normën e caktuar në bazë të Udhëzimit Administrativ të MASH-it, paguhën si orë mbinormë.
- 12.** Ministria e Arsimit dhe Shkencës merr përsipër që të vazhdojë marrjen e masave të nevojshme për normalizimin e numrit të nxënësve për çdo klasë, jo më shumë se 28 nxënës.
- 13.** Mësimdhënësit gëzojnë të drejtën për punë mbinormë, të paguar deri në 30% të ngarkesës mësimore normë.
- 14.** Orët shtesë mbinormë, për veprimtaritë edukative -mësimore në ditët e pushimit javor dhe festave për realizimin e programit ose të aktiviteteve zyrtare, që bëjnë punëdhënësit, do të paguhën sipas legjislacionit të punës në fuqi.
- 15.** Nëse mësimdhënësi, që do të shkojë në pension, ka filluar vitin shkollor, do të vazhdojë punën deri në përfundim të vitit shkollor, me pagë të plotë.
- 16.** Nëse shkolla ka më pak se 250 nxënës, drejtori i asaj shkolle mban gjysmë norme mësimore sipas UA të MASH-it.

Takimi i Komitetit të Përhershëm për Barazinë Gjinore të ETUCE-së **Sigurimi i barazisë dhe arsimit gjithëpërfshirës në raste emergjente**

Me 16-17 shkurt 2021 u mbajt takimi i Komitetit të Përhershëm për Barazinë Gjinore të ETUCE.

Takimi u mbajt online me temën " Roli i sindikatave të arsimit në sigurimin e barazisë dhe arsimit gjithëpërfshirës në raste emergjente".




Pjesëmarrëse në këtë takim nga SBASHK-u ishte Nënkryetarja e SBASHK-ut Vjollca Shala në cilësinë e Anëtares së Komitetit të Përhershëm të Barazisë Gjinore të ETUCE.

Takimin e përshëndetën Drejtorja e Evropës znj. Susan Flocken, znj. Haldis Holst – zëvendësja e Sekretarit të përgjithshëm të EI-së dhe Larry Flanagan – President e ETUCE.

Takimi u drejtua nga Rossella Benedetti- Presidente e Komitetit të Barazisë Gjinore.

Në takim u trajtuan pasojat e Covid-19 mbi barazinë dhe gjithë përfshirjen në arsim si dhe u prezantua programi i ri i punës të ETUCE 2021-2024.



Programi i punës i ETUCE 2021-2024

Barazia, Diversiteti dhe Gjithëpërfshirja

- Plani i veprimit për barazi, diversitet dhe gjithë-përfshirje ETUCE
- Gjithë-përfshirja e BE dhe politikat e barazisë
- Puna e Këshillit të Evropës lidhur me barazinë dhe gjithë-përfshirjen.

Kushtet e punës, mbrojtja sociale, shëndeti

- Koha e punës, leja prindërore dhe e kujdesit.
- Mundësi të barabarta për gra dhe burra.

Humaniteti dhe çështja e të drejtave të sindikatave dhe demokracia

Përtëritja e sindikatave

Arsimi dhe mjedisi

Ditën e dytë u diskutua barazia në sektorin e Arsimit, e ardhmja në botën e punës si dhe Projekti i Rekomandimeve mbi rolin e sindikatave të arsimit në sigurimin e barazisë dhe gjithë përfshirjes në periudha krize, si periudha e Covid-19.

Me 17 shkurt në diskutimin plenar u diskutua edhe zbatimi i Planit të Veprimit të ETUCE mbi Barazinë Gjinore nga sindikatat e Evropës e poashtu edhe nga SBASHK-u.



Edhe Shtatë Marsi po vjen ndryshe këtë vit

Kolegët pensionistë nuk do t'i kemi bashkë në Kryeqytet

Stafi qendror i SBSHK-ut me kohë kishte nisur gjithë përgatitjet për të vazhduar me traditën e shkëlqyer të organizimit të Manifestimit madhështor në respekt të ditës së madhe të mësuesit dhe shkollës shqipe. Ishte dëshirë e arsyeshme që edhe këtë vit të bëhen bashkë kolegët tanë të pensionuar mes dy marseve, por ka raste kur gjërat nuk varën e nuk ndodhin bazuar në dëshirën dhe angazhimin e singertë, po diktohen nga kushtet dhe rrethanat aktuale. Situata aktuale me Covid ka bërë që të jenë të ndaluara aktivitetet me qindra pjesëmarrës. Duke u gjendur në këtë situatë, por duke qenë kategorik, që kjo datë e madhe duhet kujtuar dhe tradita e shprehjes së respektit meritor për pishtarët e dijes nuk ka si të ndalet. Stafi qendror në koordinim me kryetarët e nivelit komunal dhe të Universiteteve vendosi që takimet solemne me kolegët tanë të pensionuar të organizohen nëpër komunat e Kosovës. Aktivitete të

shumta për këtë ditë të shënuar do të mbahen edhe në të gjitha institucionet arsimore të Kosovës. Kudo do të lartësohet kujtimi për pishtarët e dijes që nga shkolla e parë e deri më sot.

Urime!



Takimi me kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të Universiteteve

Arritjet, zgjedhjet në SBASHK dhe aktivitetet për ditën e mësuesit



Krahas komunikimit të vazhdueshëm e të përditshëm me veprimtarët sindikal, SBASHK vazhdon të mbajë takime pune me kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të Universiteteve. Në takimin e radhës është zhvilluar debat përmbajtjesor lidhur me arritjet në realizimin e kërkesave të anëtarësisë, të detyrave konkrete, lidhur me procesin e nisur në vitin zgjedhor në

SBASHK dhe për angazhimet dhe përgatitjet për shënimin e ditës së madhe të mësuesit dhe shkollës shqipe.

Në hapje të këtij takimi kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj ka kujtuar pjesëmarrësit për angazhimet dhe arritjet duke u ndalur të kërkesa për shtesën në paga për gjithë të punësuarit në arsim për arsye të shtimit të volumit të punës në rrethanat e reja që u krijuan nga pandemia dhe për arsye të rrezikut të madh të prekjës nga Covidi. Po ashtu kryetari kujtoi edhe nënshkrimin e Kontratës së re Kolektive të Arsimit mes MASH dhe SBASHK-ut duke përgëzuar edhe një herë angazhimin dhe përkushtimin e përfaqësuesve të SBASHK në komisionin e përbashkët të dialogut dhe negocimit. Jasharaj pas kësaj ka folur edhe për vitin zgjedhor në SBASHK duke apeluar për angazhim e përkushtim në mënyrë që zgjedhjet të

kenë rrjedhë të mbarë dhe të zhvillohen nga shoqatat sindikale, pastaj në Kuvendet komunale sindikale e të Universitete , të niveleve arsimore e për t'u përgatitur kështu për Kongresin e radhës. Ai ka kujtuar edhe për angazhimet e përgatitjet e bëra për nder të ditës së mësuesit dhe shkollës shqipe duke shprehur respekt meritore për koordinatorin Ymer Ymeri, stafin dhe kryetarët e nivelit komunal dhe të Universiteteve.

Pas kësaj është zhvilluar një bashkëbisedë për gjithë këto çështje nga pjesëmarrësit e këtij takimi. Koordinatorin për organizim të brendshëm Ymer Ymeri ka treguar se SBASHK ka dërguar kërkesë zyrtare te sekretari i përgjithshëm i MASH, z. Agim Bërdyna për botimin e Kontratës Kolektive dhe se është përgatitur edhe pamja e kopertinës dhe se gjasat janë që se shpejti Kontrata e shtypur të nis të shpërndahe në

institucionet arsimore dhe te institucionet lokale e qendrore. Ymeri ka dhënë edhe detaje lidhur me rrjedhën e zgjedhjeve duke prezantuar formularët dhe dokumentacioni tjetër shërbim të rrjedhës së mbarë të zgjedhjeve në të gjitha nivelet. Po ashtu është bashkëbiseduar edhe lidhur me aktivitetet kushtuar festës së madhe të ditës së mësuesit dhe shkollës shqipe, aktivitete këto që do organizohen ndryshe nga vitet e kaluara për shkak të rrethanave dhe kufizimeve për shkak të pandemisë. SBASHK, u tha, edhe përkundër situatës shumë të vështirësuar, nuk i harron pishtarët e dijes dhe në shenjë respekti të lartë për të pensionuarit ka përgatitur mirënjohje si shenjë respekti e kujtimi për punën e tyre në misionin e shenjtë të edukimit e arsimit të brezave nëpër vite dekada. Këto mirënjohje do të ndahen në ceremonitë festive që do të organizohen nga SBASHK nëpër komunat e Kosovës dhe në Universitete.

Veprimtarët sindikal Rexha, Murati e Selimi

U pensionuan, po në SBASHK do të jenë tërë jetën

SBASHK përgatit me kujdes e respekt çdo vit mirënjohje për pishtarët e dijes për të lartësuar kujtimin për punën dhe angazhimin e tyre nëpër vite e dekada në shërbim të edukimit të brezave. Gjithë këta njerëz janë krenari e arsimit dhe e SBASHK-ut. Respekt për qindra kolegë që u pensionuan nëpër vite. Respekt për kolegët që u pensionuan edhe në periudhën nga marsi i vitit të kaluar e deri në marsin 2021. Mes tyre pashë edhe tre veprimtarë të cilët janë pensionuar dhe i kanë thënë lamtumirë ditarit, shkollës, kolegëve e nxënësve. Janë këta Rexha, Murati e Selimi, mësimdhënës e veprimtar të shkëlqyer sindikal. Ata në shtator nuk do t'i shohim në shkollë, po në SBASHK do të jenë tërë jetën.



Rexha mësimdhënës i shkëlqyer e veprimtar i madh sindikal. Me shembullin e tij prej njeriu korrekt e me prirje për një humor të lehtë krijoi atmosferë uniteti në Ferizaj, komunë kjo që u dallua me

organizim sindikal dhe me numër të madh të anëtarësisë. Rexha ishte për një mandat edhe nënkryetar i SBASHK-ut duke qenë i përkushtuar, i ashpër shpesh në takime me institucione, por i afërt e korrekt me kolegët. Kur ndodhte ndonjë situatë pak sa më e acaruar, Rexha me një humor të lehtë e në llogarinë e tij e kthente atmosferën dhe puna e përkushtimi nuk kishte të ndalur.



Murati, mësimdhënës i shkëlqyer dhe me plot respekt mes kolegëve. Veprimtar i hershëm sindikal. Në Suharekë punoi me përkushtim dhe ishte shembull i mirë i bashkëpunimit dhe vazhdimit të angazhimeve me kryetarin paraprak.

Këtë nuk e kishte të vështirë sepse bëhet fjalë për veprimtarin sindikal Sadik Shala, i cili pa hezitim ju gjet pranë Muratit dhe iu gëzua shumë arritjeve sindikale në Suharekë dhe në nivel vendi.



Selimi, një punëtor i dalluar arsimor. Njohës i shkëlqyer i gjuhës shqipe e letërsisë. I përkushtuar në aktivitetet sindikale. U gëzohej arritjeve të SBASHK dhe atë e thoshte kudo e publikisht. Me fjali

të zgjedhura e me kujdes diskutonte vazhdimisht duke dhënë këshilla e duke shtuar atmosferën e entuziazmit.

Rexha, Murati e Selimi u pensionuan, po në SBASHK do të jenë tërë jetën. Respekt për ju dhe gjithë pishtarët e dijes që punuat me vite e dekada në shërbim të arsimit shqip të Kosovës.

SBASHK kërkesë publike për IKSHPK-në dhe Ministrinë e Shëndetësisë **Punëtorët arsimor të kenë prioritet për vaksinën anti-Covid**

Shifrat e arritura në taskforcën qendrore në MASH kishin dëshmuar se në periudhën e parë të këtij viti shkollor sektori i arsimit ishte nga më të prekurit me Covid-19 dhe kjo kishte bërë që institucionet gjegjëse të merrnin vendim për përfundimin më herët të periudhës së parë të mësimit në tërë sistemin e Arsimit Parauniversitar të Kosovës.

Periudha e dytë e procesit mësimor nisi më 18 janar dhe fillimisht gjendja ishte relativisht e qetë dhe jepte shpresë se do të vazhdohej me mësimin në institucionet arsimore. Mirëpo ka ditë që raportet nga ISHKP-ja flasin se fatkeqësisht është në ngritje numri i të prekurve me Covid në vendin tonë. Kjo e vërtetë e hidhur krijon frikë të arsyeshme se mund të kemi një situatë alarmante në institucionet arsimore dhe shtim të vazhdueshëm të numrit të të prekurve me Covid, gjë që do të krijojë rrethana të reja dhe situatë kur duhet menduar edhe për versione të tjera të procesit mësimor, duke mos përjashtuar mësimin nga larg, gjë të cilën nuk e dëshiron askush.

Me qëllim që të bëhen angazhime konkrete dhe të kemi parakushte modeste për vazhdimin procesit mësimor në institucionet arsimore SBASHK i drejtohet me kërkesë publike Institutit të Shëndetit Kombëtar të Kosovës dhe Ministrisë së Shëndetësisë që me të nisur të procesit të vaksinimit kundër Covid-19 në agjendën e tyre të këtij aktiviteti fort të rëndësishëm prioritet të kenë punëtorët e sektorit të arsimit. Ky do të ishte kontribut konkret me vlerë në shërbim të rrjedhës së mbarë të procesit mësimor dhe përmbylljes me sukses në institucione arsimore të këtij viti shkollor. Për këtë na duhen punëtorë arsimor të mbrojtur e të mbështetur nga institucionet, Këshilli i prindërve dhe shoqëria civile.

